

PUNËTORI PËR KORRESPONDENTË

# INFORMIMI DHE EDUKIMI MEDIAL

Në organizim të LSHPM më 18.01.2019 në Shkup u mbajt punëtorja për korrespondentët e "Penzioner plus", "Penzionerski vidici" dhe "KOHA" në të cilën morën pjesë edhe anëtarë të Këshillit botues dhe redaksisë. Së pari rreth katërdhjetë të pranishmëve e përcollën daljen e Dragi Argirovski kryetar i LSHPM dhe të Këshillit botues të gazetës "Penzioner plus" në temën: "Informimi, lajmet e rrejtshme dhe gjuha e urrejtjes".

Në daljen e tij Dragi Argirovski theksoi që ditë pas dite lajmet e rrejtshme, dezinformatat, spekulimet, shpifjet, diskriminimi dhe ofendimet po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e përditshmërisë. Gjithnjë e më shumë shkatërrohen standardet për punë dhe sjellje profesionale të gazetarëve dhe mediave. Argirovski daljen e mbaroi me mesazh që bashkëpunëtorët dhe korrespondentët duhet të jenë kundër lajmeve të rrejtshme dhe gjuhës së urrejtjes, ta respektojnë dhe nxitin të vërtetën, njerëzimin, besimin, dëshirën e mirë, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin reciprok, si deri tani, ashtu edhe në të ardhmen. Dalja e ardhshme ishte e Kalina Slivovska-Andonova, - kryeredaktore e gazetës "Penzioner



plus" dhe redaktore e "Penzionerski vidici", në temën: "Edukimi medial".

Edukimi medial nënkupton posedim të njohurive nga edukimi informatik dhe kompjuterik së bashku, por edhe të njohurive dhe aftësive për kërkim në internet dhe njohje të lajmit të vërtetë i cili dalon nga manipulimet. Pa posedim të edukimit medial, nuk mund të flitet për kompetencën profesionale të një gazetari bashkëkohor, por edhe të çdo poseduesi të informacioneve. Pastaj ajo foli që është e nevojshme pasurimi i përmbajtje-

ve të mediave, por edhe të ueb-faqes së LSHPM dhe nënfaqeve të cilat rregullisht duhet të aktualizohen, ndërsa ato shoqata të cilat nuk kanë ueb faqe të tyre do të ishte mirë që ta formojnë.

Fjalim në këto tema kishte edhe Stanka Trajkova, sekretar i KE të LSHPM. Ajo e theksoi rëndësinë e informimit. Saltir Karievski, nënkryetari i KE të LSHPM foli për rëndësinë e mbajtjes së punëtorive të këtylla për shkëmbim të përvojave dhe për mënyrën e rregullt të punës në gazetari. Besnik Pocesta, kryetari i kuvendit të LSHPM me

lëvdata u shpreh për informimin në LSHPM dhe rekomandoi që ajo të vazhdojë në mënyrë edhe më të suksesshme. Ai shprehi kënaqësinë që në "Penzioner plus" ka faqe në gjuhën shqipe dhe faqe për pensionistët në gazetën "KOHA". Mendime të tyre në lidhje me këto tema si dhe propozime për avancimin e informimit të pensionist dhanë: Taska Gavrovsk, Verica Tocinovska, Efto Gojkovski, Vele Aleksoski, Krste Spaseski, Ilija Gligorov, Dobro Todorovski, Spirko Nikolovski, Nada Aleksova dhe Cveta Spasikova. (I.G)

## Aksion për ndihmë të personave të moshuar dhe të sëmurë

Këto ditë në organizim të Qendrës për menaxhim me kriza të cilën e udhëheq Suzana Taseska pranë Kuvendit të komunës Kërçovë, së bashku me organizatën komunale të Kryqit të kuq të qytetit, ndërsa në bashkëpunim me Aktivin e pensionistëve pranë SHP Kërçovë, në hapësirat e Shtëpisë së pensionistëve në Kërçovë. Banorëve të shtëpisë në emër të qendrës për kriza iu shpërndanë paketa modeste me gjëra ushqimore, ndërsa në

emër të Kryqit të kuq iu shpërndanë batanije për fjetje. Në këtë takim të përmbledhës, para Aktivit të pensionistëve dhe para banorëve të shtëpisë së pensionistëve fjalim dha udhëheqësi i Qendrës për menaxhim me kriza Suzana Taseska e cila theksoi që në programin e tyre qëndron të ndihmojnë personat e moshuar dhe të sëmurë, ndërsa me ligjërime profesionale në temë mbrojtje parandaluese të personave të moshuar në kushte të ajrit të ndotur foli d-r Lençe Krsteska e punësuar në qendrën mjekësore Kërçovë dhe aktiviste pranë Organizatës komunale të Kryqit të kuq Kërçovë, e cila banorëve të shtëpisë së pensionistëve iu dorëzoi batanijet. Në fund u arrit në përfundim që nëse zgjat kjo gjendje e vështirë e ajrit të ndotur do të furnizohen edhe maska mbrojtëse për personat më të moshuar dhe për ata me sëmundje kronike. (.R)



## Zgjedhje për organet në Saraj

Shoqata e pensionistëve në Komunën e Sarajit, e cila është anëtare e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, në pajtim me rekomandimet e Lidhjes i publikoi dhe realizoi zgjedhjet për organet dhe trupat.

Në fillim, zgjedhjet u zbatuan në tri degët: Saraj, Kondovë dhe Bukoviq, ku krahas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të degës, u propozuan edhe anëtarët për Kuvendin e Shoqatës.

Seanca konstituive e Kuvendit u mbajt më 19.01.2019 në të cilën për kryetar të Kuvendit përsëri u zgjodh Baki Bakiu dhe sipas Statutit, u zgjodhën edhe 13 anëtarë të Kuvendit, 5 anëtarë të Këshillit ekzekutiv, 3 anëtarë të Këshillit mbikëqyrës dhe 3 anëtarë të Komisionit për statut dhe çështje juridike.

Për delegat në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Kuvendi e zgjodhi Baki Bakiun, përderisa për Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Qytetit të Shkupit, Gajur Ajdini. Këshilli ekzekutiv i shoqatës, seancën konstituive e mbajti më 29.01.2019 dhe në të njëjtën për kryetar përsëri u zgjodh Mahir Duraku. Ky organ ekzekutiv zgjodhi edhe nga 3 anëtarë të komisioneve: për sport dhe aktivitete sportive, për ekskursionë, për rekreacion, jetë kulturore-argëtuese dhe për shëndetësi dhe çështje sociale.

Gjatë zgjedhjes së organeve dhe trupave, Shoqata kishte parasysh mirëmbajtjen e vazhdueshmërisë në punë, por organet dhe trupat i ripërtëriu me anëtarë të ri, duke i respektuar edhe përkatësinë nacionale dhe fetare. (B.B)



## Ndihmë financiare e pakthyeshmë e për 196 pensionistë të sëmurë

Vitin që kaloi SHP Kumanovë e rrumbullakosi në mënyrë më të mirë të mundshme, me çka me të drejtë llogaritet në liderët mes shoqatave pensioniste në shtet. Ajo çka meriton vëmendje të veçantë, kur janë në pyetje aktivitetet e realizuara me sukses, është shpërndarja e ndihmës financiare të pakthyeshme pensionistëve të sëmurë. Për realizimin e këtij qëllimi, është formuar Komisioni në përbërje të dr Jordan Xhimrevski, motër e lartë medicinale Bisera Ilievaska dhe Aliriza Ramani, pensionist nga Mateçi. Ai punon sipas rregullave dhe udhëzimeve të Rregullores për shpërndarje të ndihmës financiare të pakthyeshme pensionistëve të sëmurë. Komisioni mblidhet çdo tre muaj, i shqyrton kërkesat e marra dhe vendos për shpërndarjen e ndihmës. Sëmundjen janë të kategorizuara dhe të grupuara dhe sipas kriterëve të vërtetuara zgjidhen lutjet e arritura.

Të dhënat e fundit thonë që në tremujorin e parë janë miratuar mjete në shumën prej 192.000 denarë 41 pensionistëve, në tremujorin e dytë 49 pensionistëve të sëmurë të cilëve u është paguar 230.000 denarë, 238.000 denarë u janë shpërndarë 51 pensionistëve në tremujorin e tretë, ndërsa në tremujorin e katërt 55 pensionistëve të sëmurë u janë transferuar 270.000 denarë në llogari ose gjithsej 1.036.500 denarë 196 pensionistëve të sëmurë.

Mjetet që u shpërndanë pensionistëve të sëmurë variojnë prej 3000 deri 6000 denarë, ndërsa përqindja më e madhe shpërndahet për sëmundjet malinje, në vendin e dytë janë sëmundjet kardiovaskulare, si grupi i tretë janë mbjellja e implanteve, ndërsa në grupin e katërt janë sëmundjet tjera. Edhe në vitin e ardhshëm, Komisioni do të punojë sipas Rregullores, për çka në planin financiar të SHP Kumanovë janë planifikuar mjete prej 1.200.000 denarë. (J.T)